



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Rregullore Nr. 12/2024
Për Procedurën E Përzgjedhjes Dhe Emërimin E Drejtorit Të Sekretariatit Të
Panelit Zgjedhor Për Ankesa Dhe Parashtresa

Prishtinë, 30.09.2024

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 123, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 2 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 30 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhje e mbajtur më datë 30.09.2024;

Miraton:

RREGULLORE Nr. 12/2024
PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIN E DREJTORIT
TË SEKRETARIATIT TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE
PARASHTRESA

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për procesin e përzgjedhjes, emërimit dhe mandatin e Drejtorit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, përfshirë kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë kandidatëve për Drejtor të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, komisioneve të themeluara me këtë rregullore si dhe ndaj të gjithë zyrtarëve të tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa të cilët janë të përfshirë në këtë proces.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. **Ligji** - Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- 1.2. **LZP** - Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik;

- 1.3. **Këshilli** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.4. **PZAP** - Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- 1.5. **Drejtor i Sekretariatit të PZAP** - Drejtorin e Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- 1.6. **Komisioni Përzgjedhës** – Komisionin ad - hoc i themeluar nga Këshilli Gjyqësor, përgjegjës për zhvillimin e procedurave lidhur me vlerësimin e kandidatëve për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-së;
- 1.7. **Anëtar i Komisionit** - anëtarin e emëruar nga Këshilli, i cili kryen detyrat dhe përgjegjësit në pajtim me këtë rregullore;
- 1.8. **KPMSHCK** - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Zyrtarët Publik;
- 1.9. **NjMBNJ**- Njësi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

2. Për qëllim të kësaj rregullore, komponentët e vlerësimit të përdorura në vijim, kanë këtë kuptim:

- 2.1. **mendimi strategjik** – aftësi për të kuptuar dhe ndërlidhur gjërat në kontekst më të gjerë dhe për të zhvilluar një vizion të qartë dhe afatgjatë të organizatës, si dhe aftësi për të përgatitur strategji dhe plane për realizimin e atij vizioni;
- 2.2. **leadership** - aftësi për të drejtuar dhe përcaktuar drejtimin e institucionit, për të inspiruar të tjerët dhe ndërtuar ekipe efektive, si dhe për të përdorur qasje të ndryshme të udhëheqjes kur nevojitet;
- 2.3. **mendimi kreativ** - aftësi kreative, përherë në kërkim të mënyrave të reja për të arritur rezultatet e dëshiruara, duke vënë në pikëpyetje rregullisht mënyrat tradicionale të punës dhe duke vlerësuar dhe zhvilluar ide të reja;
- 2.4. **zgjdhja e problemeve** - aftësi për të analizuar informatat dhe demonstruar fleksibilitet në të menduarit;
- 2.5. **orientimi drejt rezultateve** - është orientimi drejt përmirësimit të shërbimeve dhe të kuptuarit e nevojave dhe synimeve të përdoruesit të shërbimeve, është vazhdimisht i orientuar nga rezultati dhe është i aftë të përcaktojë objektivat dhe matjen e arritjeve të tyre;
- 2.6. **komunikimi** - aftësi komunikimi në mënyrë verbale dhe me shkrim, brenda dhe jashtë institucionit, duke përdorë metoda të ndryshme për audienca të ndryshme;
- 2.7. **menaxhimi** - njohuri për sistemet për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financave, si dhe aftësi në planifikim dhe organizim, i gatshëm të delegojë përgjegjësi;
- 2.8. **përshtatja** - aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve të zhvendosura, kërkesave dhe afateve kohore dhe për t'u përballë me konflikte dhe stresse, i vetë-motivuar, i vendosur por jo agresiv;
- 2.9. **puna në ekip** – aftësi për të bashkëpunuar me një varg njerëzish dhe për të mbajtur marrëdhënie efektive me të gjithë akterët;
- 2.10. **zhvillimi i vetës dhe i të tjerëve** - aftësia për të kuptuar pikat e forta dhe të dobëta personale dhe adresimin e tyre, gjithmonë i gatshëm për të mësuar nga përvojat dhe

- nga të tjerët, për të ndërtuar kapacitete dhe për të zhvilluar talentin;
- 2.11. **integriteti** - vepron në bazë të vlerave të qarta, shërben si shembull i ndershmërisë, integritetit, modestisë ndaj të tjerëve dhe është politikisht i paanshëm.
3. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 4

Parimet e përgjithshme për përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP

1. Këshilli në pajtim me parimet kushtetuese të sistemit gjyqësor dhe legjislacionin në fuqi, realizon procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të një procesi të hapur dhe konkurrues pas shpalljes publike të pozitës.
2. Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, duhet të siguroj profesionalizmin, integritetin, mosdiskriminimin, transparencën, pavarësinë, paanshmërinë, meritokracinë, si dhe të pasqyroj natyrën shumë etnike dhe parimet e barazisë gjinore siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Drejtor i Sekretariatit të PZAP

1. Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, ka mandat të zyrtarit të nivelit të lartë drejtues në Sekretariatit të PZAP-së.
2. Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, përzgjidhet nga Komisioni përzgjedhës i emëruar nga Këshilli në përputhje me procedurat, kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe me këtë rregullore.
3. Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, është përgjegjës ndaj PZAP-së për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme për PZAP-në, si dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tjera të përcaktuara nga Këshilli lidhur me PZAP-në. Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, i raporton drejtpërdrejt kryesuesit/PZAP-së.
4. Për qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së punëve dhe ushtrimit të përgjegjësive që bien në fushë veprimtari të Sekretariatit, Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, nxjerr vendime dhe akte juridike të nevojshme për administrimin dhe menaxhimin e personelit, buxhetit dhe proceseve të punës në administratën e PZAP-së, në pajtim me politikat e përcaktuara nga ana e PZAP-së dhe Këshillit.
5. Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, për punën dhe aktivitetet e Sekretariatit i raporton PZAP-së dhe kryesuesit të PZAP-së. Raportimi në PZAP bëhet çdo gjashtë (6) muaj dhe sipas kërkesës së

kryesuesit dhe PZAP nga i njëjti mund të kërkohen edhe raportime të veçanta. Raporti me shkrim i Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, i dorëzohet Këshillit.

6. Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, për shkaqet dhe rrethanat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara në Këshill, mund t'i delegojë kompetencat e tij ndonjë zyrtari tjetër.

7. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të funksionit nga Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, PZAP në pajtim me legjislacionin në fuqi cakton një zyrtar tjetër të lartë që e zëvendëson atë.

KAPITULLI II

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT

Neni 6

Kriteret e përgjithshme për pranim

1. Kandidatët për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-it, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

- 1.1. të jetë shtetas të Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë diplomë universitare në fushën e drejtësisë;
- 1.3. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal, dhe të mos ketë pasur masë disiplinore të shqiptuar në pesë (5) vitet e fundit;
- 1.4. të ketë së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, nga të cilat pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
- 1.5. të mos jetë shpallur fajtor për vepër penale;
- 1.6. në gjashtë (6) vitet e fundit të mos ketë ushtruar funksion në subjekte politike apo të mos ketë qenë kandidat, i zgjedhur apo i emëruar në organe legjislative apo ekzekutive të nivelit qendror dhe lokal;
- 1.7. të ketë njohuri mbi organizimin e sistemit gjyqësor dhe funksionimit të procesit zgjedhor dhe vendimmarrës ndaj ankesave të subjekteve politike;
- 1.8. të ketë njohuri në të folur dhe shkruar të njëjës nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

2. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, duhet të demonstrojnë edhe kompetencat e mëposhtme të përcaktuara me legjislacionin për zyrtarët publik:

- 2.1. mendimi strategjik;
- 2.2. lidershipi;
- 2.3. mendimi kreativ;
- 2.4. zgjidhja e problemeve;
- 2.5. orientimi drejt rezultatit;
- 2.6. komunikimi;
- 2.7. menaxhimi;
- 2.8. përshtatja;

- 2.9. puna në ekip;
- 2.10. zhvillimi i vetës dhe i tjerëve;
- 2.11. integriteti.

Neni 7

Shpallja dhe organizimi i konkursit

1. Këshilli me vendim shpall konkurs për pozitën e lirë të Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit dhe i njëjti publikohet në web faqen zyrtare të Këshillit dhe PZAP-së, si dhe në mjete të përshtatshme të informimit.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohës, siç përcaktohet me LZP të nivelit të lartë drejtues, procedura për emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, fillon brenda tridhjetë ditëve (30) nga dita e lirimit të pozitës.
3. Në rastet kur tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të parë nuk propozohet vazhdimi i mandatit të Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 19 të kësaj rregullore, Këshilli kërkon nga NJMBNJ fillimin e procedurave për rekrutimin, në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore dhe legjislacionit në fuqi.
4. Procedura e konkurrimit për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, organizohet nga NJMBNJ, në Sekretariatit e Këshillit.
5. Pranimi në pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, bëhet me konkurs të hapur dhe publik.
6. Pranimi i aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, e as më i gjatë se njëzet (20) ditë.
7. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga NjMBNj dhe përmban të dhënat, si në vijim:
 - 7.1. titullin e pozitës;
 - 7.2. përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi;
 - 7.3. kriteret e përgjithshme për pranim, sipas nenit 6 të kësaj rregullore;
 - 7.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë, që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme);
 - 7.5. dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim, mënyrën, procedurën dhe afatin për paraqitjen e aplikimit;
 - 7.6. datën e fillimit të zhvillimit të procedurës së konkurrimit;
 - 7.7. datën për shpalljen e rezultateve, pas verifikimit paraprak;
 - 7.8. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve;
 - 7.9. datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;
 - 7.10. mënyrën e njoftimit/komunikimit me kandidatët, përmes postës elektronike;
 - 7.11. aplikacionin që duhet të plotësohet dhe mënyrën e aplikimit;
 - 7.12. kërkesën për koncept dokumentin zhvillimor për Sekretariatit.

8. Të gjitha shpalljet e konkurrimit duhet gjithashtu të përmbajnë edhe këto shënime:

- 8.1. komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP;
- 8.2. gjinia më pak e përfaqësuar inkurajohet të aplikojë për pozita të nivelit të lartë drejtues në pajtim me LZP;
- 8.3. aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen;
- 8.4. shpallja e konkurrimit, publikohet në pajtim me Ligjin përkatës për Përdorimin e Gjuhëve.

Neni 8

Mënyra e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme

1. Kandidatët që konkurrojnë në pozitën e shpallur për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-së, dorëzojnë dokumentet si në vijim:

1.1. aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara:

- 1.1.1. një referencë në shpalljen e konkurrimit;
- 1.1.2. të dhënat personale të kandidatit, duke përfshirë emrin, adresën, telefonin dhe datën e lindjes;
- 1.1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara në institucionet arsimore, përfshirë edhe datat e diplomimit;
- 1.1.4. të mos jetë i dënuar për veprë penale, në përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.1.5. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, kohëzgjatjen e punës, një përshkrim të shkurtër të detyrave, arsyet për largim nga vendi i punës;
- 1.1.6. njohuritë gjuhësore;
- 1.1.7. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, dhe publikimet;
- 1.1.8. njohuritë kompjuterike;
- 1.1.9. të dhënat bankare dhe asetet;
- 1.1.10. përvoja e përgjithshme e punës dhe përvoja menaxheriale;
- 1.1.11. të dhënat lidhur me shqiptimin e masave eventuale disiplinore;
- 1.1.12. të dhënat lidhur me trajnimet e specializuara.

1.2. certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;

1.3. certifikatën nga Evidenca Penale të lëshuar nga gjykata;

1.4. kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, ndërsa për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;

1.5. kopjet e dëshmisë së punësimit, që përfshin pozitën dhe datat e mbajtjes së pozitës;

1.6. kopja e diplomave për trajnimet, si dhe kopjet dokumenteve që dëshmojnë plotësimin e çdo kushti për aplikim, të përcaktuara në shpalljen e konkursit;

- 1.7. koncept dokumentin zhvillimor për Sekretariatit jo më pak se tre (3) faqe dhe jo më shumë se pesë (5) faqe.
2. Kandidatët e plotësojnë aplikacionin në pajtim me Ligjin përkatës për Përdorimin e Gjuhëve.
3. Nëse numri i aplikacioneve të pranuar të kandidatëve është më pak se tre (3), procedura ekzistuese e konkurrimit vazhdohet edhe për pesë (5) ditë tjera kalendarike nga NjMBNj. Nëse pas vazhdimit të procedurës së konkurrimit numri i aplikacioneve të kandidatëve është më pak se tre (3), por së paku dy (2) kandidatë plotësojnë kushtet, procedura e rekrutimit vazhdon me fazat e tjera të vlerësimit.
4. Në rast se procedura e rekrutimit e shprehur si në paragrafin 3 të këtij neni, përfundon pa të paktën dy (2) kandidat që plotësojnë kushtet, ose nuk kalojnë pragun minimal të pesëdhjetë për qind (50 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës për tu dërguar në PZAP për emërim, procedura përfundohet dhe organizohet procedurë e re rekrutimi, jo më vonë se tre (3) ditë nga data e përfundimit.
5. Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse dorëzohet në NjMBNj të Këshillit në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.
6. Për secilin kandidat krijohet dosje e cila përmban të gjitha dokumentet e prezantuar nga kandidati. Komisioni për Rekrutim dhe NjMBNj për formimin dhe mbajtjen e dosjes sigurojnë kompletimin dhe përditësimin e saj deri në momentin e përmbylljes përfundimtare të procesit të përzgjedhjes.

Neni 9

Komisioni Përzgjedhës

1. Këshilli pas çdo shpallje të pozitës së lirë për Drejtor të Sekretariatit të PZAP, me vendim themelon Komisionin përzgjedhës i cili do të bëjë intervistimin, vlerësimin dhe propozimin e kandidatit më të suksesshëm tek PZAP, për emërim.
2. Komisioni përzgjedhës përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, si vijon:
 - 2.1. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kryesues;
 - 2.2. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Një profesor fakulteti me përvojë së paku dhjetë (10) vjeçare në fushën e të drejtave të njeriut ose në të drejtën zgjedhore, anëtar;
 - 2.4. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 2.5. Një përfaqësues nga radha e organizatave të shoqërisë civile, me përvojë së paku pesë (5) vjeçare në fushën e të drejtave të njeriut ose në të drejtën zgjedhore, anëtar.
3. Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP bazohet në parimet e konkurrencës, mos diskriminimit, transparencës, integritetit dhe objektivitetit.

4. NjMBNj është përgjegjëse për mbështetjen administrative të Komisionit Përzgjedhës.

5. Këshilli për anëtar të Komisionit Përzgjedhës si në paragrafin 2, nën paragrafin 2.3 të këtij neni, i dorëzon kërkesën së paku dy universiteteve, që t'i përcjellin emrat e profesorëve që plotësojnë kushtet e përcaktuara për anëtar të Komisionit Përzgjedhës për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së.

6. Kandidatët për anëtarë të Komisionit Përzgjedhës (një përfaqësues nga radha e organizatave të shoqërisë civile) përpos kriterit në paragrafin 2, nën paragrafin 2.5 të këtij neni duhet t'i plotësojnë kriteret, si në vijim:

- 6.1. të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
- 6.2. të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën në katër (4) vitet e fundit;
- 6.3. të kenë integritet moral dhe profesional;
- 6.4. të mos jetë i dënuar për veprë penale, në përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 6.5. të mos jetë i punësuar në shërbimin civil;
- 2.6. të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore.

7. NjMBNj para shpalljes së konkursit për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-së, i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar listën me emrat e propozuar për kandidatët për anëtar të Komisionit Përzgjedhës sipas paragrafit 2, nën paragrafit 2.3 dhe 2.5 të këtij neni. Për anëtarë të Komisionit Përzgjedhës, përfaqësues nga radha e organizatave të shoqërisë civile, NjMBNj publikon shpalljen publike në afat prej dhjetë (10) ditë kalendarike për pranimin e propozimeve.

8. NjMBNj listën me kandidatët e propozuar ia dërgon Këshillit para shpalljes publike të konkursit për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-së.

9. Këshilli gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit nga paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 dhe 2.5 të këtij nenin, mbështet në bazë të një procedure transparente, publike dhe konkurruese duke caktuar peshën specifike të secilit kriter dhe metodën e vlerësimit.

10. Procedura është e vlefshme vetëm nëse marrin pjesë shumica e anëtarëve të Komisionit. Anëtarët e Komisionit që fillojnë me intervistimin e kandidatëve, nuk mund të ndryshohen gjatë procesit.

Neni 10

Konflikti i Interesit

1. Konflikt interesi paraqet çdo rrethanë e cila për subjektet bartëse të procesit të përzgjedhjes të Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, do të konsiderohej si interes privat që ndikon, mund të ndikoj ose duket se do të ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tyre, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.
2. Subjektet bartëse të procesit të përzgjedhjes duhet të bëjnë përpjekje ta parandalojnë dhe/ose t'i shmangen çfarëdo situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Shfaqja e ndonjë konflikt interesi do të jetë po aq e dëmshme për respektin e publikut për punën e kryer nga Këshilli sikur edhe vet konflikti aktual i interesit.
3. Në rast se gjatë procesit të përzgjedhjes, ndonjë subjekt bartës të procesit beson se mund të ketë konflikt interesi, ai/ajo duhet ta njoftoj menjëherë me shkrim për këtë çështje kryetarin e komisionit përkatës, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj.
4. Në rast se konflikti i interesit lidhur me procesin e përzgjedhjes, paraqitet nga kryetari i komisionit, i njëjti me shkrim e njoftojnë Këshillin, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj.
5. Subjektet bartëse të procesit të përzgjedhjes, me rastin e paraqitjes së konfliktit të mundshëm të interesit detyrohen që menjëherë të pezullojnë çfarëdo veprimi të mëtejshëm, deri sa të vendoset lidhur me përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj, sipas përcaktimit të bërë me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.
6. Në rast se subjektet bartëse të procesit të përzgjedhjes sipas këtij neni gjenden në një situatë të konfliktit të interesit me ndonjë kandidat dhe një fakt të tillë e kanë mbajtur të fshehur, për subjektin bartës të procesit, tërheq përgjegjësi disiplinore. Në një situatë të tillë, Këshilli do të shqyrtoj mundësinë e anulimit dhe përsëritjes së komplet procesit.

Neni 11

Kompensimi i Komisionit Përzgjedhës

Anëtari i Komisionit Përzgjedhës, një profesor fakulteti dhe një përfaqësues nga radha e organizatave të shoqërisë civile, përfiton një pagesë fikse prej dy qind e pesëdhjetë (250 €) euro. Pagesa bëhet nga Sekretariati i PZAP-së, për çdo procedurë konkurrimi në të cilën merr pjesë anëtari i Komisionit Përzgjedhës, ndërsa për anëtarë të komisionit të cilët paguhet nga buxheti i shtetit kompensohen sipas Ligjit për Paga në Sektorin Publik.

Neni 12

Verifikimi paraprak i kandidatëve

1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit, nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit.
2. Komisioni Përzgjedhës, në mbështetje të NjMBNj-së, pas mbylljes së konkursit, shqyrton të gjitha aplikacionet e pranuar të kandidatëve sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.
3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Komisioni Përzgjedhës në mbështetje të NjMBNj-së përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional.
4. Komisioni Përzgjedhës, përkatësisht NjMBNj, pas verifikimit, publikon në SMDEAGj (kur e njëjta të jetë funksionale) dhe web faqen zyrtare të Këshillit dhe PZAP, listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike, jo më vonë se tre ditë (3) kalendarike nga data e mbylljes së konkursit.
5. Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara, si në paragrafin 4 të këtij neni, njoftohen përmes faqes zyrtare të Këshillit, PZAP-së dhe postës elektronike, pesë ditë (5) para mbajtjes së intervistës, për kohën dhe vendin e intervistimit.
6. Në rast të refuzimit të aplikacionit, kandidati njoftohet individualisht përmes NJMBNJ-së, lidhur me arsyet e refuzimit.

Neni 13

Vlerësimi i integritetit të kandidatit

Vlerësimi i integritetit të kandidatit për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-së, bëhet përmes vërtetimit dhe verifikimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale dhe sigurimi i të dhënave për masat eventuale disiplinore të shqiptuara nga punëdhënësi, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 14

Intervistimi

1. Komisioni Përzgjedhës vlerëson kandidatin për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, duke u bazuar në koncept dokumentin zhvillimor të Sekretariatit të PZAP, si dhe nga intervistimi që ndërlidhet me njohuritë për vendin e punës, aftësitë profesionale dhe kompetencës.
2. Intervista dhe koncept dokumenti vlerësohet me më së shumti një qind (100) pikë, dhe atë:
 - 2.1. koncept dokumenti vlerësohet me më së shumti dyzet (40) pikë.

- 2.2. njohuritë për vendin e punës deri në njëzet (20) pikë;
- 2.3. njohuritë profesionale deri në njëzet (20) pikë; dhe
- 2.4. njohuritë e kompetencës deri në njëzet (20) pikë.

3. Komisioni Përzgjedhës në kushte dhe hapësira konfidenciale në ditën e mbajtjes së intervistës përgatit pyetjet lidhur me njohuritë për vendin e punës, njohuritë profesionale dhe të kompetencës, duke mos përjashtuar parashtrimin e pyetjeve të caktuara lidhur me koncept dokumentin e dorëzuar për qëllime të vlerësimit.

4. Intervista me gojë regjistrohet përmes kamerave dhe për këtë njoftohet kandidati, për të cilën kërkohet pëlqimi i tij. Të gjithë kandidatëve ju ofrohet kohëzgjatje e njëjtë e intervistës me gojë. Kohëzgjatja e intervistës me gojë, nuk mund të jetë më e shkurtër se njëzet e pesë (25) minuta.

5. Vlerësimi i kandidatëve nga intervistimi bëhet menjëherë pas përfundimit të intervistimit të kandidatit.

Neni 15

Hartimi i listës përfundimtare dhe shpallja e rezultateve

1. Komisioni Përzgjedhës brenda shtatë (7) ditëve bënë intervistimin e kandidatëve, përgatit raportin përfundimtar për dërgim në PZAP dhe bënë publikimin e rezultateve. Rezultati përfundimtar për suksesin e përgjithshëm të një kandidati bëhet sipas formularit standard. Rezultati për një (1) kandidat arrihet duke nxjerrë mesataren e pikëve të dhëna nga secili anëtar i komisionit.

2. Rezultati i arritur për secilin kandidat shënohet në procesverbal, i cili përmban pikët e dhëna nga secili anëtar i Komisionit Përzgjedhës sipas formularit standard, i cili para së gjithash duhet të përmbaj edhe arsyetim të qartë për secilën kategori dhe kriter vlerësues, si dhe pikët totale që ka marrë secili kandidat.

3. Formulari standard i vlerësimit nga secili anëtar i Komisionit përzgjedhës sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe formulari standard i procesverbalit të Komisionit përzgjedhës sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të nënshkruhen nga anëtari i komisionit. Këta formular standard do të jenë pjesë e kësaj rregullore.

4. Kandidati për tu vendosur në listën e ngushtë për propozim në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të PZAP-së për emërim në PZAP duhet të kaloj pragu prej së paku pesëdhjetë (50%) përqind të pikëve nga secila fushë që vlerësohet. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e arrin këtë prag, atëherë Komisioni Përzgjedhës njofton me raport me shkrim Këshillin. Këshilli vendos sipas dispozitave të kësaj rregullore për përsëritjen e konkursit.

5. Lista e ngushtë sipas paragrafit 4 të këtij neni, nuk mund të përmbajë më pak se dy (2) e jo më shumë se pesë (5) kandidatë të cilët rangohen sipas numrit të pikëve më të larta të arritura në intervistë, si dhe përmban arsyetim të Komisionit përzgjedhës për përparësinë e dhënë disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.

6. NjMBNj publikon listën e ngushtë të kandidatëve për Drejtor të Përgjithshëm të PZAP-së, në faqen zyrtare të Këshillit dhe PZAP.

Neni 16 **Raporti final i procesit përzgjedhës**

1. Komisioni Përzgjedhës në bashkëpunim me NjMBNj, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, përgatit raportin final me shkrim, përmes të cilit përshkruhet rrjedha e tërë procesit.
2. Raporti sipas paragrafit 1 të këtij neni i dorëzohet PZAP, i cili pas miratimit publikohet në faqen zyrtare të Këshillit dhe PZAP.

Neni 17 **Përzgjedhja përfundimtare dhe emërimi**

1. Pas pranimit nga Komisioni përzgjedhës të listës së ngushtë me kandidatët fitues, PZAP do të shqyrtoj dosjen e kompletuar për secilin kandidat dhe sipas nevojës mund të kërkoj edhe sqarime shtesë nga kryetari i Komisionit përzgjedhës.
2. PZAP, me votim të hapur, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, përzgjedh Drejtorin e Sekretariatit të PZAP-së. Kandidati që merr shumicën e votave të anëtarëve të PZAP, konsiderohet i përzgjedhur dhe emërohet si Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së.
3. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk arrin shumicën e votave në raundin e parë (1) sipas paragrafit 2 të këtij neni, organizohet një raund i dytë (2) i votimit. Nëse janë më shumë se dy (2) kandidat fitues, atëherë për votim propozohen dy (2) kandidatët me më së shumti vota nga raundi i parë (1) i votimit. Kandidati që merr shumicën e votave të anëtarëve të PZAP, konsiderohet i përzgjedhur si Drejtor i Sekretariatit të PZAP-së.
4. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk arrin shumicën e votave sipas paragrafit 3 të këtij neni as në raundin e dytë (2) të votimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, organizohet një raund i tretë (3) i votimit. Në raundin e tretë (3) të votimit, propozohen sërish dy (2) kandidatët fitues me më së shumti vota nga raundi i dytë (2) i votimit. Kandidati që merr shumicën e votave të anëtarëve të PZAP-së, konsiderohet i përzgjedhur si Drejtor i Sekretariatit të PZAP.
5. Nëse edhe në raundin e tretë (3) sipas paragrafit 4 të këtij neni, asnjëri kandidat nuk merr shumicën e votave të anëtarëve të PZAP-së, përfundohet procedura e përzgjedhjes së Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së dhe organizohet një procedurë e re konkurrimi për këtë pozitë.
6. NjMBNj, pas emërimit sipas rasteve të përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, njofton kandidatin që brenda afatit tridhjetë (30) ditor të nënshkruajë aktin e emërimit dhe të fillojë punën. Si datë e fillimit të punës konsiderohet dita parë pas nënshkrimit të akt emërimit dhe nga kjo datë fillon numërimi i mandatit për Drejtorin e Sekretariatit të PZAP-së.

7. Në rast se nuk nënshkruhet akt emërimi brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, procedura e rekrutimit konsiderohet si e përfunduar dhe vazhdohet me procedurë të re të rekrutimit për pozitën e Drejtorin e Sekretariatit të PZAP-së.

Neni 18 **E drejta ankesës**

Kandidati i pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ka të drejtë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në Ligjin përkatës për Procedurën Administrative.

Neni 19 **Mandati i Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së**

1. Mandati i Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, është katër (4) vjet, me të drejtë vazhdimi për vetëm edhe një (1) herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje.
2. PZAP bën vazhdimin e mandatit të Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, nëse në fund të mandatit të parë mesatarja e performancës së mandatit të tij është vlerësuar së paku me vlerësimin “arrin pritshmëritë”, si dhe nëse nuk ka pasur të shqiptuar ndonjë masë për shkelje të rëndë disiplinore gjatë mandatit të parë.
3. Kryesuesi i PZAP-it propozon vazhdimin e mandatit, të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së.
4. Nëse nuk ka propozim për vazhdim të mandatit, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, konsiderohet që mandati i Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, nuk vazhdohet dhe i propozon Këshillit të fillojë procedurat e rekrutimit.
5. Procedura e vazhdimit të mandatit nga ana e PZAP-it do të zhvillohet përshtatshëm sipas procedurës së parë të përzgjedhjes dhe emërimit.

Neni 20 **Programi i veçantë i trajnimit**

1. Pas emërimit, Drejtori i Sekretariatit të PZAP ndjek programin e veçantë të trajnimit për kategorinë e lartë drejtuese sipas LZP-së dhe akteve të tjera të miratuara nga Këshilli.
2. Refuzimi i detyrimit për t’iu nënshtruar programit të veçantë të trajnimit për nëpunësin e kategorisë së lartë drejtuese, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.

Neni 21

Emërimi pas përfundimit të mandatit

1. Nëse Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, pas përfundimit të mandatit të parë nuk i vazhdohet edhe një (1) mandat nga PZAP, ose ka përmbytur dy (2) mandate, dhe i njëjti vjen nga radhët e stafit të brendshëm të administratës së sistemit të drejtësisë, NJMBNJ duhet të sistemoj në pozitën e punës në të cilën ka punuar paraprakisht, nëse ajo pozitë është e lirë, në të kundërtën duhet të sistemoj në një pozitë të ngjashme që i përshtatet kualifikimeve të tij. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e caktuar nga NJMBNJ, përbën shkak për lirimin e nëpunësit nga shërbimi civil.
2. I emëruari si Drejtori i Sekretariatit të PZAP-së, i cili para emërimit nuk ka qenë pjesë e shërbimit civil, pas përfundimit të mandatit lirohet nga shërbimi civil.

Neni 22

Ruajtja e dosjes së kandidatit

1. Materiali i intervistimit ruhet dhe arkivohet së bashku me dosjen e kandidatit të suksesshëm, në bazë të rregullave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare.
2. Këshilli mban dosjen në formën elektronike dhe fizike për kandidatin e përzgjedhur për Drejtor të Sekretariatit të PZAP-së, e cila përmban të dhënat personale, si dhe të gjitha materialet e grumbulluara gjatë procesit të përzgjedhjes. Të dhënat janë konfidenciale dhe qasja në dokumentet e ruajtura, bëhet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Me kërkesë me shkrim, pas përfundimit të procesit të rekrutimit kandidati ka të drejtë të ketë qasje në të dhënat e përmendura nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. Dokumentet personale të kandidatëve të cilët nuk e kanë kaluar provimin, pas regjistrimit të të dhënave për ruajtje, me kërkesën e tyre u kthehen, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pas përfundimit të procesit të rekrutimit, në të kundërtën pas kalimit të afatit ligjor të njëjtat do të asgjësohen.

Neni 23

Ruajtja e dosjes së procesit të përzgjedhjes

Dosja e procesit të përzgjedhjes ruhet dhe mbyllet në momentin e përfundimit të tij. Të dhënat janë konfidenciale dhe qasja në dokumentet e ruajtura, bëhet në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Neni 24

Përgjegjësia për zbulimin e të dhënave

1. Lidhur me mënyrën, llojin dhe vëllimin e zbulimit të të dhënave është përgjegjës vetëm Këshilli.

2. Në rast se zbulohet çfarëdo e dhënë apo informatë lidhur me procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, në mënyrë të paautorizuar, në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe këtë rregullore nga subjektet bartëse në këtë proces, trajtohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës dhe zbulim i fshehtësisë zyrtare.

Neni 25 **Shtojcat e rregullores**

1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur kësaj rregullore janë pjesë përbërëse e saj:

- 1.1. Shtojca Nr. 1: Aplikacioni për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së;
- 1.2. Shtojca Nr. 2: Formulari i vlerësimit nga anëtari i Komisionit Përzgjedhës për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së;
- 1.3. Shtojca Nr. 3: Formulari i vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së;
- 1.4. Shtojca Nr. 4: Procesverbali i intervistës së kandidatit për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së.

Neni 26 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet çdo akt nënligjor dhe dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë rregullore.


Neni 27 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: ____ . ____ . ____

 <p>REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA</p> <p>APLIKACION PËR POZITËN E DREJTORIT TË SEKRETARIATIT TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA PRIJAVA ZA POZICIJU GENERALNOG DIREKTORA SEKRETARIJATA IZBORNOG PANELA ZA ŽALBE I PREDSTAVKE</p>	INFORMACIONET PËR KANDIDATIN INFORMACIJE O KANDIDATU									
	Emri (emri i prindit) mbiemri /Ime (ime roditelja) prezime									
	Numri personal / Lični broj									
	Vendi i punës dhe pozita/Radno mesto i pozicija									
	Adresa e banimit/Adresa stanovanja:									
	Nr. i telefonit/Broj tel:									
	E-mail adresa/ Imejl adresa:									
	Numri i Konkursit/ Broj Konkursa	Kandidati është i obliguar të shënojë adresën, numrin e telefonit, dhe adresën elektronike. Kandidat je dužan da navede adresu, broj telefona, i elektronsku adresu.								

Këshilli Gjyqësor i Kosovës („KGjK“) si institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij siguron që gjykatat në Kosovë të jenë plotësisht të pavarura, profesionale e të paanshme dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumë etnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Në drejtim të kësaj, KGjK ka për obligim kushtetues që të sigurojë përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë për pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, në qëllim të përmbushjes së plotë të funksioneve të gjykatave dhe atë me respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në pajtim me Konventat ndërkombëtare dhe legjislationin vendor.

Sudski savet Kosova („SSK“) kao potpuno nezavisna institucija u sprovođenju svojih funkcija obezbeđuje da su sudovi na Kosovu nezavisni, profesionalni i nepristrasni i da odražavaju multietničnost na teritoriji Republike Kosova kao i da poštuju načela polne jednakosti. U tom smislu, SSK ima ustavnu obavezu da obezbedi odabir najboljih kandidata za poziciju generalnog direktora Sekretarijata Izbornog panela za žalbe i predstavke kako bi obezbedila potpuno i pravilno funkcionisanje sudova a time obezbedila i potpuno poštovanje ljudskih prava i osnovnih sloboda u skladu sa međunarodnim konvencijama i domaćim zakonom.

UDHËZIMET / UPUTSTVA

- 1.Kandiati duhet të plotësojë aplikacionin në mënyrë elektronike ose me shkrim në mënyrë të qartë duke përdorur lapsin me ngjyrë të kaltër. / *Kandidat treba da popuni prijavu elektronskim ili pisanim putem, čitko i koristeći olovku plave boje.*
- 2.Kandidati duhet të plotësojë aplikacionin në tërësi. / *Kandidat je dužan popuniti prijavu u potpunosti.*
- 3.Kandidati është i obliguar të shënojë „P/P“ (pa përgjigje) në hapësirën e pyetjes në të cilën nuk ka përgjigje. Aplikacioni i paplotësuar mund të shkaktojë eliminim të kandidatit nga përzgjedhja për pozitën e aplikuar. Të gjitha të dhënat e parashtruara nga kandidati i nënshtrohen procesit të verifikimit. / *Kandidat je dužan obeležiti određeni prostor sa „B/O“ (bez odgovora) ispod pitanja na koje nema odgovor. Nepotpuna prijava može dovesti do eliminacije kandidata iz procesa selekcije za prijavljenu poziciju. Navedene informacije od strane kandidata biće podvrgnute procesu verifikacije.*
